



PROCESI I DËMSHPËRBLIMIT TË ISH-TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NË SHQIPËRI

Analizë historike, juridike dhe sociale

**PROCESI I DËMSPËRBLIMIT
TË ISH-TË PËRNDJEKURVE
POLITIKË NË SHQIPËRI**

Analizë historike, juridike dhe sociale

Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi

Deklarata e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Themelore të Viktimave të Krimit dhe Keqpërdorimit të Pushtetit

“Viktimat kanë të drejtë të marrin dëmshpërblim të menjëhershëm për dëmin e pësuar. Për më tepër, shtetet duhet të angazhohen për të siguruar masa efektive për kompensimin financiar të viktimave, duke krijuar mekanizma të përshtatshëm dhe të aksesueshëm për këtë qëllim”.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së nr.40/34,
29 nëntor 1985

Ky studim është pjesë e kontributit të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për drejtësinë tranzitore dhe është bashkëfinancuar me Fondacionin Konrad Adenauer. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autores dhe nuk pasqyrojnë, domosdoshmërisht, qëndrimin zyrtar të Prezencës ose të Fondacionit Konrad Adenauer.

Redaktimi Ligjor: Erjola Likaj

ISBN 9789928395795

Falënderim për Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Drejtësisë për bashkëpunimin dhe kontributin në vënien në dispozicion të informacionit të nevojshëm për hartimin e këtij materiali.

Në vend të Hyrjes	7
I. Rëndësia e Dëshmërbimit për Ish-të Përndjekurit Politikë	9
I.1 Natyra e Procesit të Dëshmërbimit.....	13
II. Konteksti Historik dhe Ligjor	14
III. Zbatimi dhe Sfidat e Ligjit Nr. 9831, date 12.11.2007, “Për Dëshmërbimin e Ish-të Përndjekurve Politikë të Regjimit Komunist” i Ndryshuar	19
III.1 Statistikat e Aplikimeve të Paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë dhe Rregullat për Rivendosjen në Afat të Kërkesave të Dorëzuara Jashtë Afateve Ligjore.....	25
IV. Shpërndarja dhe Përdorimi i Fondit Vjetor të Buxhetit të Shtetit për Dëshmërbimin e Ish-të Përndjekurve Politikë (2005-2025)	29
IV.1 Analizë Analitike e Shpërndarjes së Dëshmërbimit për ish-të Përndjekurit Politikë	32
IV.2 Administrimi dhe Përdorimi i Fondit të Buxhetit për Institutin e Integritetit të Ish-të Përndjekurve Politikë.....	33
V. Pajtueshmëria me Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut	36
VI. Problematikat dhe Sfidat në Zbatimin e Akteve Ligjore	38
VI.1 Kriteret për të Vlerësuar Efektivitetin e Procesit	39
VII. Perspektivat dhe Përmirësimet e Mundshme Ligjore.....	42
VIII. Përfundime	44
IX. Rekomandime.....	47
Referenca	49
Legjislacioni	49
Dokumenta dhe Raporte.....	50

Në vend të hyrjes

Analiza e politikave dhe procedurave për *dëmshpërblimin* e ish-të përndjekurve politikë është një proces i domosdoshëm për të kuptuar se si shteti ka trajtuar *drejtësinë* për viktimat e regjimit komunist. Këto politika kanë qenë thelbësore për të rikthyer sadopak drejtësinë për ata që kanë vuajtur nga *persekutimi politik* dhe janë privuar nga të drejtat e tyre themelore. Duke shqyrtuar në detaje se si janë ndërtuar dhe zbatuar procedurat e dëmshpërblimit për këta individë dhe familjet e tyre, ne mund të vlerësojmë jo vetëm efektivitetin e tyre ligjor dhe praktik, por gjithashtu ndikimin që ato kanë pasur në krijimin e një klime të *drejtësisë sociale* dhe *pajtimit kombëtar*.

Në këtë kontekst, është thelbësore të vlerësohen rezultatet konkrete të këtyre proceseve përmes shqyrtimit të disa pyetjeve përgjatë kësaj analize: *A kanë përmirësuar ato cilësinë e jetës së ish-të përndjekurve? A kanë ofruar një mundësi për rehabilitimin social dhe ekonomik të viktimave?* Analiza e këtyre pyetjeve na lejon të kuptojmë më thellë nëse përpjekjet për dëmshpërblim kanë ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë.

Gjithashtu, krahasimi i praktikave shqiptare me ato të vendeve të tjera që kanë kaluar periudha të ngjashme totalitare është një hap i domosdoshëm për të nxjerrë *mësime* nga përvojat e të tjerëve. Shtete të ndryshme në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë pasur qasje të ndryshme për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe rikthimin e pronave. Duke analizuar se si këto

vende kanë trajtuar çështje të ngjashme, Shqipëria mund të mësojë dhe të përmirësojë politikat e saj, duke siguruar një proces më të drejtë dhe më efikas për viktimat gjatë periudhës së komunizmit.

Ky material ka për qëllim të ofrojë përmes një analize të thelluar historike, juridike dhe sociale të procesit të dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë, problematikat e hasura përgjatë viteve duke vënë në pah sfidat dhe pasojat që ky proces ka sjellë për viktimat dhe shoqërinë shqiptare në tërësi. Gjithashtu, synon të shërbejë dhe si një thirrje për *angazhim* më të madh nga ana e institucioneve shtetërore për të përmirësuar procesin e dëmshpërblimit dhe për të siguruar që të gjithë individët që kanë vuajtur padrejtësisht të kenë mundësinë të realizojnë të drejtat e tyre. Njëkohësisht ky material synon të nxisë debatin akademik ndërmjet studiuesve të fushës së të drejtave të njeriut dhe studentëve të fushës së jurisprudencës, dhe më gjerë akoma.

Përmes kësaj analize do të bëhen rekomandime konkrete për *përmirësimin* e mëtejshëm të procesit të dëmshpërblimit. Këto rekomandime synojnë të theksojnë nevojën për përmirësime në fushën e mbështetjes sociale dhe ekonomike për viktimat, me qëllim që ato të mos mbeten thjesht simbole të pajtimit formal, por të përfitojnë realisht nga drejtësia dhe rehabilitimi.

I. Rëndësia e Dëmshpërblimit për Ish-të Përndjekurit Politikë

Dëmshpërblimi për viktimat e regjimit komunist ka një *rëndësi të jashtëzakonshme*, duke u parë jo vetëm si një veprim ligjor, por edhe si një mjet thelbësor për të korrigjuar *padrejtësitë historike*. Për shumë ish-të përndjekur politikë, procesi i dëmshpërblimit përfaqëson një njohje të vuajtjeve të tyre dhe një hap drejt rikthimit të dinjitetit të humbur. Kjo formë drejtësie, pavarësisht nëse është simbolike ose materiale, është një përpjekje për të përballuar dëmet e shkaktuara nga një regjim që me dekada përndoqi njerëz për bindjet e tyre politike, fetare apo intelektuale. Një raport i Këshillit të Evropës¹ trajton pyetjen nëse çdo person i dënuar padrejtësisht duhet të ndjekë një procedurë individuale për përmbysjen e vendimeve gjyqësore, apo nëse lloje të caktuara vendimesh politike dhe gjyqësore duhet të anulohen në mënyrë të përgjithshme. Raporti thekson se dëmshpërblimi material për këto

1 Nga Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut. Raportues: Z. Severin, Rumani, Grupi Socialist.

Raporti bazohet në një qasje me dy drejtime. Së pari, përpiqet të tregojë pse është kaq e rëndësishme që trashëgimia e regjimeve totalitare komuniste të mëparshme të çmontohet, dhe si mund të arrihet kjo. Së dyti, ngre problemin e arritjes së drejtësisë pa shkelur të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu përshkruan zgjidhje për këtë problem, duke përfshirë udhëzime konkrete se si të sigurohet që, ligjet e lustracionit dhe masa administrative të ngjashme, të jenë në përputhje me kërkesat e një shteti të bazuar në sundimin e ligjit, që shpresohet të jenë të pranueshme për një publik të gjerë.

viktima të regjimit totalitar është një domosdoshmëri dhe duhet të jetë i drejtë dhe proporcional. Në këtë kontekst, dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit nuk duhet të jetë më i ulët se ai që u ofrohet individëve të dënuar padrejtësisht për krime të zakonshme në kohët aktuale.² Kësisoj, njohja dhe dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit politikë mbeten një detyrim moral dhe ligjor për shoqëritë demokratike, si një mënyrë për të riparuar dëmet dhe për të forcuar besimin në drejtësi dhe barazi. Një raport për të mbijetuarit e pakompensuar, publikuar nga Departamenti i Shtetit i SHBA-së në vitin 2020, nënvizon rëndësinë e vazhimit të përpjekjeve për ofrimin e ndihmës për të mbijetuarit që kanë mbetur ende të prekur nga padrejtësitë e të kaluarës.³

Dëmshpërblimi për ish-të përndjekurit politikë nuk duhet parë vetëm si një çështje financiare apo ligjore, por edhe si një mekanizëm i rëndësishëm për rehabilitimin e tyre psikologjik dhe social. Studimet mbi drejtësinë tranzitore theksojnë se riparimi i dëmeve historike është i lidhur ngushtë me procesin e ripajtimit dhe rikthimit të besimit në institucionet demokratike (Teitel, 2000)⁴. Sipas Lederach (1997)⁵, rikuperimi social dhe psikologjik i individëve të prekur nga represioni politik nuk mund të arrihet vetëm përmes kompensimit material, por kërkon edhe njohjen publike të vuajtjeve të tyre dhe një përpjekje për të rikrijuar lidhjet shoqërore të dëmtuara, të dinjitetit të ish-të përndjekurve, dhe në rritjen e përfshirjes së tyre në jetën publike. Shpesh, këta individë kanë vuajtur jo vetëm në aspektin fizik dhe ekonomik, por edhe në atë emocional dhe psikologjik.⁶ Një proces i mirëstrukturuar dëmshpërblimi mund të ketë gjithashtu efekte pozitive në marrëdhëniet mes shtetit dhe qytetarëve të dëmtuar. Kur shteti njih gabimet e tij të së kaluarës dhe ndërmerr hapa konkretë për t'i trajtuar ato, krijon një lidhje më të fortë besimi me shoqërinë.

2 Council of Europe. Measures to Dismantle the Heritage of Former Communist Totalitarian Systems. Accessed December 2, 2024. <https://www.coe.int>

3 The Department of State's *Justice for Uncompensated Survivors Today (JUST) Act Report* to Congress, released publicly in July 2020, [Section 1. Respect for the Integrity of the Person](https://www.state.gov/reports/just-act-report-to-congress/) can be found on the Department's website: <https://www.state.gov/reports/just-act-report-to-congress/>

4 Teitel, R. G. (2000). *Transitional Justice*. Oxford University Press.

5 Lederach, J. P. (1997). *Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies*. United States Institute of Peace Press.

6 Gjatë periudhës së qëndrimit në burgjet e regjimit në Shqipëri, një total prej 984 personash humbën jetën si pasojë e kushteve të rënda dhe torturave, ndërsa 308 të tjerë pësuan dëmtime të rënda mendore, duke çuar në humbjen e aftësive të tyre intelektuale dhe psikologjike.

Kjo, nga ana tjetër, ndihmon në nxitjen e *pajtimit kombëtar* dhe *stabilitetit social*. Një qasje e drejtë dhe transparente në procesin e dëmshpërblimit mund të shërbejë si një mesazh i fuqishëm që shteti është i gatshëm të përballet me të kaluarën dhe të ndërtojë një të ardhme më të drejtë për të gjithë qytetarët.

Dëmshpërblimi i ish-të përndjekurve politikë është një temë komplekse dhe shpeshherë ngatërrohet me koncepte të tjera të drejtësisë, si ajo restauruese apo shpërndarëse. Procesi i *dëmshpërblimit* të ish-të përndjekurve politikë në Shqipëri është një aspekt kyç i përpjekjeve për *drejtësi tranzitore* dhe rikthimin e dinjitetit të individëve që vuajtën nën regjimin komunist. Parimi i *dëmshpërblimeve* për ata që kanë përjetuar përndjekje politike është thelbësor për të siguruar të drejtat e njeriut dhe për të ndrequr padrejtësitë historike. Sipas Cohen (2016), arsyet për ndërmarrjen e një reforme korrektuese, që ka për qëllim korrigjimin e padrejtësive të kaluara, nuk duhet të përdoren si bazë për të justifikuar lloje të tjera drejtësie, si drejtësia restauruese apo shpërndarëse. Kjo ndodh sepse dëmshpërblimi i ish-të dënuarve politikë nuk duhet parë si një përfitim në kuadrin e drejtësisë restauruese apo shpërndarëse.⁷ Drejtësia restauruese dhe shpërndarëse merren kryesisht me mënyrën se si ndahen të mirat dhe përgjegjësitë brenda një grupi ose shoqërie. Në këtë kuptim, ato trajtojnë çështje që lidhen me mirëqenien e përbashkët dhe barazinë sociale. Ndërkohë, dëmshpërblimi i ish-të dënuarve politikë synon të trajtojë padrejtësi të caktuara që kanë ndodhur në të kaluarën dhe të japë një formë riparimi për dëmet e shkaktuara. Me fjalë të tjera, Cohen thekson se ndërhyrjet korrektuese duhet të mbeten të përqendruara në rregullimin e padrejtësive të së kaluarës, pa u ngatërruar me mekanizmat e drejtësisë që synojnë shpërndarjen e barabartë të të mirave në shoqëri. Kjo ndarje ndihmon për të mbajtur të qartë qëllimet dhe arsyetimin pas secilit lloj drejtësie. Ruti Teitel, në librin e saj *Transitional Justice*, argumenton se drejtësia tranzitore është një përgjigje ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut që ndodhin në periudha të tranzicionit politik dhe shoqëror. Ajo e përkufizon këtë drejtësi si një proces që ndihmon shoqëritë të përballen me të kaluarën e dhimbshme, duke nxitur pajtimin dhe stabilitetin në periudha të ndryshimeve të mëdha. Përmes kësaj, drejtësia tranzitore vepron si një mjet kryesor për të trajtuar

7 Cohen, Andrew I. *Philosophy, Ethics, and Social Justice: Critical Perspectives*. New York: Routledge, 2016

traumën historike dhe për të ndërtuar një të ardhme më të drejtë.⁸ Jon Elster, në librin *Closing the Books: Transitional Justice in Historical Perspective*, analizon mekanizmat e ndryshëm që përdoren për të zbatuar drejtësinë tranzitore, si gjyqet, komisionet e së vërtetës dhe masat riparuese, të cilat përdoren për të adresuar padrejtësitë e të kaluarës. Ai hulumton gjithashtu ndikimet politike dhe sociale që këto mekanizma mund të kenë në një shoqëri. Sipas tij, këto procese nuk janë vetëm mjete për të bërë drejtësi, por edhe faktorë që ndikojnë në mënyrën se si një shoqëri kalon nga një regjim shtypës në një sistem më demokratik dhe të qëndrueshëm.⁹

Pas rënies së regjimeve autoritare, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, përfshirë Shqipërinë, u përballën me sfidën komplekse të trajtimit të pasojave të *shpronësimeve* të padrejta dhe *persekutimeve* që prekën shumë individë dhe familje. Shtete si *Polonia*, e cila miratoi ligjin për *dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë* në vitin 1997,¹⁰ dhe *Republika Çeke*, që krijoi një sistem të ngjashëm në vitin 2000¹¹, kanë zbatuar procese që ofrojnë një mbështetje të plotë për viktimat e regjimeve të mëparshme. Në vendet ish-komuniste, padrejtësitë e kryera gjatë periudhës së regjimit komunist u bënë një çështje drejtësie. Gjykata kushtetuese të ndryshme kanë dhënë qëndrime mbi kornizat ligjore për dëmshpërblimin dhe riparimin për viktimat e përndjekjeve politike. Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, në Çështjen nr. 04-01(99) të vitit 1999, theksonte se qëllimi kryesor i ligjit në një shtet demokratik, duke përfshirë ligjin për përcaktimin e statusit të personave të përndjekur politikisht gjatë regjimit komunist, është drejtësia dhe sigurimi i saj. Gjykata Kushtetuese e Hungarisë ka trajtuar çështje të rëndësishme në lidhje me dëmshpërblimin për ish-të burgosurve politikë dhe thekson që dëmshpërblimi duhet të respektojë dinjitetin dhe trajtimin e barabartë të individëve që u dëmtuan nga përndjekjet politike. Në Vendimin e saj nr. 1-001-1995, Gjykata Kushtetuese thekson që çdo skemë dëmshpërblimi duhet të jetë e ndërtuar rreth parimit të respektimit të dinjitetit të barabartë për çdo person. Ky është një element kyç për drejtësinë, ku çdo person që ka vuajtur padrejtësi, si për shkak të burgimit apo

8 Teitel, Ruti G. *Transitional Justice*. New York: Oxford University Press, 2000.

9 Elster, Jon. *Closing the Books: Transitional Justice in Historical Perspective*. Cambridge: Cambridge University Press, 2004.

10 Ligji nr. 106/1997, Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë.

11 Ligji nr. 215/2000, Për përmirësimin e statusit të ish-të dënuarve politikë.

përndjekjeve politike, duhet të ketë të drejta të barabarta në dëmshpërblim. Në Vendimin e saj nr. 46/2000, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë thekson gjithashtu që, edhe pse skema e dëmshpërblimit për ish-të burgosurit politikë është e domosdoshme, çdo ligj për dëmshpërblimin duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe të respektojë buxhetin e disponueshëm të shtetit, duke theksuar që ligjvënësi ka një kompetencë të gjerë për të përcaktuar se si duhet të rregullohet kjo çështje dhe sa duhet të jetë shumta e dëmshpërblimit. Ky interpretim i Gjykatës Kushtetuese Hungareze tregon sesi përpjekjet për dëmshpërblim për të mbijetuarit e padrejtësive të së kaluarës nuk janë vetëm për të korrigjuar të kaluarën, por edhe për të respektuar dinjitetin dhe të drejtat e individëve në mënyrë të barabartë.

1.1. Natyra e Procesit të Dëmshpërblimit

Natyrë e procesit të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë përfaqëson një çështje të rëndësishme në diskutimin mbi ndërtimin e mekanizmit të dëmshpërblimit. Në thelb të diskutimit qëndron pyetja nëse ligji do ta ndërtojë këtë proces si një proces gjyqësor apo administrativ. Ligjvënësi ka hapësirë për vlerësim mbi kritere si përshtatshmëria, efektet, kostot, shpejtësia, natyra e procedurave dhe barra e vendimmarrjes për juridiksionin.

Në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore, ky mekanizëm është ndërtuar si një proces administrativ, megjithatë ka vende, si Republika Çeke, që ia kanë besuar procesin e kompensimit juridiksionit gjyqësor (Roman, 2005).¹² Republika Çeke përfaqëson një nga vendet e Evropës Juglindore që e ka përfunduar me sukses këtë reformë të drejtësisë tranzitore, jo vetëm për shkak të angazhimeve pozitive të shtetit për të mbështetur financiarisht realizimin e saj, por edhe për shkak të natyrës ligjore të vendimeve gjyqësore.

12 Roman, D. (2005). *The Transitional Justice Mechanism: Compensation for Former Political Prisoners in Central and Eastern Europe*. *Central European Review*, 6(2), pp. 45-67.

II. Konteksti Historik dhe Ligjor

Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK), gjatë periudhës së regjimit komunist u burgosën gjithsej 34,135¹³ persona për arsye politike, prej të cilëve 26,768 ishin burra dhe 7,367 gra. Të dhënat pasqyrojnë vuajtjet dhe persekutimet e shumta që shqiptarët përjetuan gjatë diktaturës komuniste. Kushtet e rënda në burgje dhe kampet e punës çuan në pasoja tragjike:

- Viktima në burgje: 984 persona humbën jetën për shkak të kushteve çnjerëzore dhe torturave;
- Dëmtime mendore: 308 individë pësuan çrregullime mendore si pasojë e trajtimeve mizore gjatë burgimit;
- Ekzekutime: 6,027 janë vrarë gjatë regjimit komunist, nga të cilët 5,577 burra dhe 450 gra u dënuan me vdekje dhe u ekzekutuan.¹⁴ Këto ekzekutime përfshinin metoda si pushkatimi ose varja, dhe trupat e viktimave rrallëherë iu ktheheshin familjarëve për varrim.

¹³ [Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit - Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit](#)

¹⁴ [Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit - Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit](#)

Kategoria	Numri i Viktimave	Përshkrimi
Viktima në burgje	984	Persona që humbën jetën për shkak të kushteve çnjerëzore dhe torturave në burgje
Dëmtime mendore	308	Individë që pësuan çrregullime mendore si pasojë e trajtimeve mizore gjatë burgimit
Ekzekutime burra	5,577	Burra të dënuar me vdekje dhe të ekzekutuar për arsye politike, shumica pa proces gjyqësor të drejtë
Ekzekutime gra	450	Gra të dënuara me vdekje dhe të ekzekutuara për arsye politike, shumica pa proces gjyqësor të drejtë
Ekzekutime totale	Mbi 6,000	Persona të ekzekutuar gjatë periudhës së regjimit komunist (1944-1991) për arsye politike
Metodat e ekzekutimit	-	Përfshijnë pushkatimin ose varjen. Trupat rrallë iu ktheheshin familjarëve për varrim.

Përveç burgosjeve, regjimi komunist internoi rreth 59,009 qytetarë në kampe përqendrimi,¹⁵ ku 7,022 prej tyre humbën jetën. Këto statistika pasqyrojnë një periudhë të errët në historinë shqiptare, ku shkeljet e të drejtave të njeriut ishin të përhapura dhe represioni politik preku mijëra familje.

Sipas të dhënave të publikuara nga Instituti për Integrimin e të Përndjekurve Politikë, numri i përgjithshëm i individëve që kanë fituar statusin e të përndjekurve politikë që prej vitit 1993 është rreth 43 mijë. Këta persona janë kategorizuar sipas grupeve të ndryshme, duke përfshirë: të pushkatuarit politikë (5,548), individët që kanë pësuar çrregullime mendore si pasojë e represionit komunist (273), të burgosurit politikë (14,563), të burgosurit politikë që kanë vdekur në burg (987), dhe të internuarit e të dëbuarit politikë (21,401).¹⁶

Pas këtij konteksti historik, është e rëndësishme të shqyrtohet kuadri ligjor që

15 [Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit – Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit](#)

16 [Instituti Për Integrimin të Ish Përndjekurve Politikë - Statistika](#)

rregullon njohjen, trajtimin dhe rehabilitimin e të përndjekurve politikë, duke përfshirë aktet ligjore në fuqi, procesin e dëmshpërblimit dhe sfidat e zbatimit të tyre. Pavarësisht parashikimeve të Ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar,¹⁷ rehabilitimi i ish të përndjekurve politikë duhet të kishte përfunduar tashmë. Ligji parashikonte një proces të qartë dhe të domosdoshëm për rikthimin e dinjitetit dhe të të drejtave të individëve që vuajtën nën regjimin komunist.¹⁸ Njëkohësisht, në këtë ligj parashikohej dhe kompensimi financiar.¹⁹ Ndryshimet kohë pas kohe të këtij ligji përcaktonin dhe përfshirjen e të internuarve për motive politike në kampe të caktuara internimi, respektivisht deri në fund të viteve 1954, 1958, 1961 dhe 1966, si subjekte që përfitojnë disa nga të drejtat që njihje ligji, përfshirë këtu edhe të drejtën për kompensim.

Ligji nr. 7748, datë 29.07.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar, përfaqësonte një hap tjetër të rëndësishëm drejt njohjes dhe garantimit të të drejtave të këtyre individëve për kompensim. Ligji parashikonte që procesi i kompensimit do të përfundonte në vitin 1994, duke ofruar gjithashtu lehtësira dhe përparësi për kërkesat individuale dhe kolektive në fushat ekonomike, financiare dhe sociale.²⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 04.05.1994, "Për dhënien e kompensimit pasuror ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i cili doli në bazë të këtij ligji, përcaktonte dhe mënyrën

17 I ndryshuar me Ligjin nr.7660, datë 14.1.1993; me Ligjin nr.7719, datë 8.6.1993; me Ligjin nr.7772, datë 7.12.1993; me Ligjin nr.8997, datë 30.1.2003

18 Rehabilitimi financiar dhe jomaterial i ish-të përndjekurve politikë u konsiderua një proces i domosdoshëm për rikthimin e dinjitetit dhe drejtësisë për ata që vuajtën nën regjimin komunist. Gjithashtu, u konsiderua e rëndësishme kthimi i ish-të përndjekurve në vendet e tyre të banimit, duke u ofruar atyre mundësi për t'u ri-integruar në shoqëri, duke përfshirë gjithashtu ofrimin e trajnimeve që lidhen me programet e punësimit, për të ndihmuar individët të gjejnë punë dhe të rikthejnë stabilitetin ekonomik.

19 Në pikën "dh" të nenit 5 të këtij ligji parashikohet që: "*Kompensimi për dëmet e shkaktuara u jepet edhe familjeve ose trashëgimtarëve të ligjshëm të ish-të burgosurve politikë që nuk jetojnë më, si dhe të atyre që janë pushkatuar pa gjyq ose që kanë vdekur pa u dënuar nga gjykata*".

20 Neni 7 i këtij Ligji përcakton nocionin e kompensimit pasuror të këtyre personave si një "*shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim në rrogë, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t'i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij, ..., në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve ...*". Në nenin 8 sqarohet më tej se këtë kompensim pasuror e përfitojnë kategoritë e përmendura në nenin 3 shkronjat 'a', 'b', 'c', dhe se nga kjo e drejtë nuk përfitojnë të përndjekurit e shkronjës 'c' (të internuarit dhe të dëbuarit), të cilët gjatë kohës që kanë gëzuar liri të kufizuar janë paguar për punën e kryer.

dhe formën e kompensimit financiar.²¹ Sidoqoftë, në zbatimin e ligjit, vonesat dhe neglizhenca nga institucionet shtetërore penguan përparimin e procesit të kompensimit.

Ligji nr. 9260, datë 15.07.2004 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, në nenin 1 përcaktonte ndryshime në nenin 9 të Ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993, si më poshtë: “*Kompensimi financiar i ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që kanë marrë pafajësinë sipas Ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991 “Për pafajësinë ...”, ... dhe që gëzojnë statusin sipas Ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin ...”, ish të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë “A”, të cilët kanë humbur jetën apo janë të sëmurë psikikë për shkak të përndjekjes, ose trashëgimtarit të radhës së parë sipas Kodit Civil, si dhe ish-të dënuarit politikë që përfshihen në kategorinë “B” të parashikuar në nenin 3 të Ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për Statusin ...”, ... përfitojnë të drejtën e kompensimit financiar në mënyrë të përshkallëzuar mbi bazën e vuajtjes së dënimit*”. Neni 1 përjashtonte nga e drejta e kompensimit financiar të internuarit politikë që kishin fituar statusin e grupit “C”, dhe që në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 7514, datë 30.09.1991, “Për pafajësinë...”, nenit 1 të Ligjit nr. 7772, datë 07.12.1993, Për disa ndryshime në Ligjin “Për pafajësinë...”, dhe neneve 8 dhe 14 të Ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, përfitojnë të drejtën e kompensimit pasuror.

Gjykata Kushtetuese, me Vendimin nr. 34, datë 20.12.2005, vendosi shfuqizimin si antikushtetues të nenit 1 të Ligjit nr. 9260, datë 15.07.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar. Në analizën e kontekstit të tranzicionit, Gjykata nënvizon se,

21 Ndër të tjera në këtë vendim saktësohet se “*Kompensimi pasuror ... do të bëhet kryesisht me letra me vlerë...*” (pika 1); se “*ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë që kanë përfitur të drejtën e kompensimit pasuror sipas Ligjit “Për statusin ...”, në zbatim të neneve 7 dhe 9, përfitojnë në formën e letrave me vlerë një kompensim vjetor prej 120.000 lekë* (pika 2); se ata kanë të drejtë të marrin pjesë pa ankand në procesin e privatizimit të pronës shtetërore; kanë të drejtë t’i shesin, disponojnë ose këmbëjnë letrat me vlerë në të gjitha format që përcakton ligji, etj. Në vendim, përcaktohen gjithashtu kategori të ndryshme të të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, që mbi bazën e disa kriterëve objektive (mosha, masa e dënimit, gjinia), do të përfitonin të drejtën të merrnin në të holla një pjesë të kompensimit. Kjo shumë, sipas rasteve të caktuara, varion nga 100,000 deri në 300,000 lekë.

pavarësisht nga shumë nga problemet e trashëguara nga e kaluara komuniste dhe vështirësitë që ka përballuar shteti, shoqëria shqiptare ka një detyrim moral dhe historik për të respektuar të drejtën e dëmshpërblimit për të dënuarit politikë, në përputhje me kushtet ekonomike dhe sociale, duke marrë masa konkrete për të gjetur një zgjidhje të shpejtë, të përshtatshme dhe të qëndrueshme (Vendimi nr. 34/ 2005). Gjykata Kushtetuese konfirmon përmes këtij vendimi që dëmshpërblimi i ish-të burgosurve politikë nuk mund të bazohet në kuadrin ligjor para tranzicionit, duke vërtetuar karakterin retroaktiv të kësaj reforme ligjore. Në të njëjtën kohë, ajo i jep ligjvënësit një orientim për vlerën e kompensimit, duke theksuar se, “kompensimi i ish-të burgosurve politikë duhet të jetë më shumë se një vlerësim simbolik dhe financiar. Vlera duhet të marrë parasysh vuajtjet e shumta të të dënuarve politikë, dinjitetin e tyre, si dhe problemet që ata hasin në jetën e përditshme”. Gjykata thekson gjithashtu se shteti demokratik duhet t’i kompensojë këta persona bazuar në mundësitë ekonomike dhe financiare, duke u bazuar në parimet e rëndësishme të drejtësisë dhe barazisë. Ndër të tjera, Gjykata nënvizon se qëllimi kryesor duhet të jetë zvogëlimi sa më shumë i pasojave të padrejtësive të shkaktuara gjatë regjimit komunist, duke e bërë të qartë se eliminimi i plotë i këtyre padrejtësive është i pamundur. Gjykata Kushtetuese thekson se “... e drejta për kompensim nuk mund të trajtohet si një e drejtë subjektive.” Gjykata nënvizon rëndësinë e respektimit të parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të të gjitha viktimave të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Sipas praktikës së Gjykatës, diskriminimi ndodh kur subjekte në të njëjtën situatë trajtohen ndryshe pa një justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv.

Në tetor të vitit 2006, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Rezolutën “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri”, e cila përmbante 17 pika, që synonin dënimin e krimeve të regjimit komunist dhe rehabilitimin e ish-të përndjekurve politikë.²²

Me miratimin e Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, u mundësua më tej procesi i dëmshpërblimit. Megjithatë, buxheti i dedikuar për këtë proces ka rezultuar i pamjaftueshëm, duke e bërë të vështirë përfundimin e tij brenda një kohe të arsyeshme.

22 [rezolute-206-11-03-2016.pdf](#)

III. Zbatimi dhe Sfidat e Ligjit Nr. 9831, Datë 12.11.2007 “Për Dëmshpërblimin e ish-të Dënuarve Politikë të Regjimit Komunist”, i Ndryshuar

Ky ligj ishte një hap i rëndësishëm në njohjen dhe riparimin e *padrejtësive të së kaluarës*, duke ofruar një bazë ligjore për dëmshpërblimin e individëve që kanë vuajtur për shkak të persekutimit politik. *Neni 6* i këtij ligji përcakton masën e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë dhe për familjarët e tyre, duke e lidhur dëmshpërblimin me periudhën e vuajtjes së dënimit. Kjo masë synon të kompensojë jo vetëm humbjen e lirisë, por edhe përjetimet traumatike që ata dhe familjet e tyre kanë kaluar. Po ashtu, *neni 10* i jep përgjegjësi Ministrisë së Drejtësisë për shqyrtimin e kërkesave për dëmshpërblim, duke siguruar transparencë dhe ndershmëri në proces.

Bazuar në mënyrën se si ligji ka ndërtuar mekanizmin e dëmshpërblimit, duhet theksuar se akti përfundimtar ligjor për dëmshpërblimin është akti administrativ kolektiv, që është vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin

e listës së përfituesve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë.²³ Ndërsa, faza e dytë e procedurës administrative të dëmshpërblimit, e cila lidhet me zbatimin e të drejtës për dëmshpërblim, i është lënë kompetencës së Ministrisë të Financave.²⁴ Në lidhje me subjektet përfituese, kuadri ligjor për dëmshpërblimin e ish-të burgosurve politikë i ndan ata në dy kategori përfituesish: kategoria parësore, e cila përfshin ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist që kanë mbijetuar, dhe kategoria jo-parësore, që përfshin anëtarët e familjes së të dënuarve që nuk jetojnë më, si dhe anëtarët e familjes së viktimave të ekzekutuara dhe personat e internuar apo të deportuar në kampe. Ligji lejon të drejtën e dëmshpërblimit për trashëgimtarët deri në shkallën e tretë, dhe e shuan këtë të drejtë për shkallë të tjera të trashëgimisë (neni 8, *“Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish-të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.”*²⁵

Kushtet dhe kriteret për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë janë të sanksionuara në nenet 12 dhe 32 të ligjit. Sipas ligjit, i gjithë procesi i dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë duhej të përfundonte brenda një periudhe prej tetë vitesh (neni 32), bazuar në disa kriteret dhe parime të përgjithshme të përshkruara në nenin 12, si prioriteti në dorëzimin e kërkesës dhe shpërndarja e barabartë e fondeve për të gjithë përfituesit. Sipas këtyre dispozitave, vlera e kompensimit nuk duhej të ishte më e ulët se 100,000 lekë dhe as më e madhe se një milion lekë.

Përcaktimi në nivel ligjor i afateve të përgjithshme për dhënien e kompensimit, sipas disa kriterëve dhe parimeve, përbënte një element shumë të rëndësishëm të parimit të sundimit të ligjit dhe të sigurisë juridike, në kontekstin e rivendosjes së të drejtave dhe dinjitetit njerëzor të ish-të dënuarve politikë që ishin dëmtuar padrejtësisht nga regjimi komunist.

23 Neni 9, Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist” https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/Ligji_per_demshperblimin_e_ish_te_denuarve_politike_i_azhurnuar1.pdf;

24 Neni 13, Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”;

25 Ligji nr. 10111, datë 2.4.2009, *Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831/2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”.*

Megjithatë, para se të fillonte zbatimi i ligjit të dëmshpërblimit në vitin 2009, skema e dëmshpërblimit pësoi ndryshime të thella, të cilat në thelb preknin pritshmëritë ligjore të krijuara për rreth dy dekada nga kjo kategori, duke krijuar një situatë të paqartë dhe të ndërlikuar. Ky zhvillim u theksua edhe në raportin vjetor të Avokatit të Popullit të vitit 2013, duke vënë në dukje ndryshimet radikale në skemën e dëmshpërblimit dhe pasojat e tyre negative për të përndjekurit politikë.²⁶

Ndryshimet ligjore të vitit 2009 goditën disa aspekte thelbësore të skemës së dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë. *Së pari*, u ndryshua parimi i barazisë në shpërndarjen e fondeve të dëmshpërblimit, duke u zëvendësuar me atë të proporcionalitetit. *Së dyti*, skema e dëmshpërblimit nuk përcaktohej më nga vetë ligji, por nga aktet nënligjore (Vendime të Këshillit të Ministrave). *Së treti*, dhe më e rëndësishmja, ndryshimet ligjore hoqën afatin e përgjithshëm 8-vjeçar, sipas të cilit shteti ishte i detyruar të përfundonte procesin e dëmshpërblimit, duke lënë procesin pa afat për përmbyllje.

Më pas, në zbatim të këtij ligji u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1253, datë 2.7.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfutur nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist” dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 17.11.2010, “Për përcaktimin e procedurave administrative të shqyrtimit të kërkesave dhe kompensimin financiar për familjet e viktimave të dënuara pa të drejtë, pa gjyq, për arsye politike, nga 30.11.1944 deri më 1.10.1991”, i ndryshuar. Sipas Vendimit nr. 933, *“familjarët e viktimave të pushkatuara pa gjyq, për motive politike, për vuajtjen dhe persekutimin, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barabartë, gjithsej, në masën e 8 (tetë) viteve kompensim dënimi me burgim. Kompensimi financiar kryhet në bazë të përlogaritjes sipas së cilës, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer në burg, dëmshpërblimi financiar është në masën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë. Nga shuma që çdo subjekt i ekzekutuar pa gjyq, për motive politike, përfiton nga ky vendim, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme”*.²⁷

Në prill të vitit 2011, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 419/2011 “Për miratimin e afateve dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të kompensimit

26 [Av.Popullit.indd](#)

27 Vendim nr. 933, datë 17.11.2010, Pika II/1, <https://qbgz.gov.al/share/zGoS900qTpCtFTwt-6eOVg>;

për të përndjekurit politikë”, ku përcaktohet se kompensimi do të ndahej në tetë këste, por pa përcaktuar një afat përfundimtar për realizimin e procesit.

Ndryshimet në aktet nënligjore të vitit 2014, megjithëse sollën disa aspekte pozitive në drejtim të përshpejtimit të kompensimit për kategorinë parësore, *përkeqësuan kornizën normative të skemës së kompensimit dhe afatet përkatëse*. Në përmbajtjen e tyre nuk gjendet asnjë afat i sanksionuar për realizimin e procesit të kompensimit dhe as elementë që rregullojnë skemën siç kërkohet nga ligji (Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit 2015). Në fakt, vendimi i delegon Ministrin të Financave të drejtën për të urdhëruar shpërndarjen e kështit të radhës sipas buxhetit të disponueshëm, pa dhënë një përgjigje ligjore dhe garanci se kur dhe si do të realizohet kompensimi i premtuar.

Autoritetet përgjegjëse për miratimin e dëmshpërblimit

- Autoriteti përgjegjës për miratimin e dëmshpërblimit: Këshilli i Ministrave miraton dëmshpërblimin financiar (neni 9).
- Shpërndarja e dëmshpërblimit: Ministria e Financave shpërndan dëmshpërblimin përmes depozitave bankare (neni 13). Buxheti ndahet në 70% për ish-të dënuarit dhe 30% për trashëgimtarët (neni 12).
- Mbikëqyrjanga Kuvendi: Kuvendi verifikon shpërndarjen e dëmshpërblimit çdo vit (neni 17).
- Evidentimi dhe krijimi i regjistrit elektronik: Të gjitha kërkesat regjistrohen në Ministrinë e Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës (neni 29).
- Fondet për zbatimin e këtij ligji: Buxheti vjetor për dëmshpërblimin planifikohet nga Këshilli i Ministrave (neni 32).
- Mbikëqyrja nga grupimet e interesit: Grupimet joqeveritare kanë të drejtë të paraqesin pretendime për moszbatimin e ligjit (neni 30).

Nenet 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9831 përcaktojnë të drejtën për dëmshpërblim si një e drejtë personale, e cila mund të zgjerohet edhe te trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, deri në një shkallë të caktuar. Këto dispozita sigurojnë që e drejta për dëmshpërblim nuk do të kalojë pa dallim përmes të gjitha shkallëve

të trashëgimisë, siç përcaktohet në Kodin Civil²⁸, duke i dhënë përparësi zbatimit të tij në lidhje me të drejtën e trashëgimisë.

Ligji nr. 9831, përveçse si një përpjekje për të adresuar pasojat e së kaluarës, duhej të shoqërohej me një zbatim efikas dhe të drejtë për të arritur qëllimin e tij kryesor.²⁹ Ndryshimet e bëra në të nga Ligji nr. 27/2017,³⁰ përcaktuan një afat të ri për paraqitjen e kërkesave për dëmshpërblim, duke krijuar mundësi për ata që mund të kishin humbur afatin fillestar.³¹

Dëmshpërblimi financiar për ish-të përndjekurit politik ka qenë një proces i gjatë dhe kompleks. Pagesat janë përllogaritur bazuar në disa kritere, ndër të cilat përfshihen **vitet e burgimit apo internimit**. Ligji përcaktonte një vlerë të caktuar për çdo vit të kaluar në burgim politik apo internim gjatë regjimit komunist. Fillimisht, kjo shumë ishte simbolike dhe është rritur gradualisht për të reflektuar inflacionin dhe vështirësitë ekonomike. Për disa **kategori të veçanta**, si të miturit apo personat me lëndime fizike gjatë burgimit, janë parashikuar kompensime shtesë. Për shembull, për çdo vit burgimi, individët mund të marrin rreth 200,000-500,000 lekë, sipas vlerësimeve të caktuara.³²

28 Ligj nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 360, "Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijve, bashkëshorti, prindërit, vëllezërit e motrat dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshi e gjyshja e të paralindurit e tjerë, personat e paafte për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë deri në shkallën e gjashtë, si dhe shteti".

29 Neni 17 dhe Neni 30 parashikojnë mbikëqyrjen nga Kuvendi dhe grupimet joqeveritare. Kjo mbikëqyrje është thelbësore për të siguruar që dëmshpërblimi të ndodhë në përputhje me ligjin dhe të respektojë të drejtat e ish-të dënuarve politikë. *Transparenca* në procesin e shpërndarjes së dëmshpërblimit është e domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut, dhe për të garantuar që dëmshpërblimi të jetë i barabartë dhe i drejtë.

30 Pamja e dokumentit - Qendra e Botimeve Zyrtare

31 Neni 4 vazhdon të përcaktojë kriteret e qarta për përfituesit e dëmshpërblimit. Ndryshimet theksojnë se individët që nuk kanë paraqitur kërkesat e tyre për dëmshpërblim deri në afatin e ri (31.12.2017) do të humbasin të drejtën për të përfituar.

32 Neni 6, "Masa e dëmshpërblimit për të burgosurit, të internuarit ose të dëbuarit politikë do të jetë si më poshtë:

a) çdo i dënuar politik, për çdo ditë vuajtjeje dënimi të kryer, në burg, spital psikiatrik, spital burgu, izolim në hetuesi, nga data 30.11.1944 deri më 1.10.1991, dëmshpërblehet financiarisht, sipas kritereve të këtij ligji, në masën 2,000 (dy mijë) lekë në ditë;

b) për personat që kanë vuajtur internim në kamp me rrethim me tela me gjemba deri në vitin 1954, masa e dëmshpërblimit është 1,000 (një mijë) lekë në ditë;

c) për personat e tjerë të internuar ose të dëbuar parashikohet një skemë pensioni, e cila do të rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Dëmshpërblimi i përcaktuar në paragrafin më sipër u takon dhe familjarëve të tij, në pjesë të barabarta takuese, kur i dënuari nuk jeton më. E drejta e familjarëve për të kërkuar dëmshpërblim është e drejtë jopasurore vetjake. Nga shuma që çdo i dënuar politik përfiton nga ky ligj, zbritet masa e dëmshpërblimit që ai ka përfituar me ligjet e mëparshme."

Një problem i shpeshtë ka qenë vonesa në shpërndarjen e fondeve. Në disa raste, ish të përndjekurit kanë pritur me vite për të marrë pagesat e tyre, ndërsa fondet kanë qenë të kufizuara dhe të varura nga buxheti vjetor i shtetit.

Sipas Raportit Vjetor të Performancës 2016–2017 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, kuadri ligjor i miratuar dhe masat e marra gjatë periudhës së tranzicionit për rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë kanë arritur vetëm pjesërisht objektivat e tyre. Raporti thekson se këto masa nuk kanë arritur të sigurojnë rehabilitimin e plotë të kësaj shtrese shoqërore në një kohë optimale. Sipas dokumentit, legjislacioni ka qenë i fragmentarizuar dhe jo gjithëpërfshirës, burimet financiare kanë qenë të pamjaftueshme dhe ka munguar koordinimi efektiv midis institucioneve shtetërore për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie. Ndërkohë, shoqëria shqiptare ka mundësi për të realizuar një dëmshtëpërlim material dhe rehabilitim të arsyeshëm, në përputhje me detyrimet ligjore dhe ato të përcaktuara nga Konventat Ndërkombëtare, duke synuar kështu mbylljen e kësaj plage shoqërore në një kohë optimale.³³

Gjatë vitit 2023,³⁴ institucioni i Avokatit të Popullit u përball me një numër të konsiderueshëm ankesash nga ish-të përndjekurit politikë. Në një rast të veçantë, një ankues i moshuar nuk u njoftua në kohë për përfshirjen e tij në listën e përfituesve, pavarësisht se emri i tij ishte publikuar mbi një vit më parë. Ky incident shënoi një shkelje të detyrimit ligjor për informimin në kohë të përfituesve përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit kërkoi përmirësimin e përgjegjshmërisë në strukturat e Ministrisë së Financave dhe theksoi rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit për zbatimin e rekomandimeve. Ai gjithashtu nënvizoi nevojën për ndërgjegjësimin e këtyre institucioneve, me synim shqyrtimin më të shpejtë të dokumentacionit dhe njoftimin në kohë të përfituesve.

33 Kontrolli i Lartë i Shtetit, 2017, f. 124, <https://panel.klsh.org.al/storage/phpm7RnTr.pdf>

34 <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/FINAL-RAPORTI%20VJETOR%202023.pdf>;

III.1. Statistikat e Aplikimeve të Paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë dhe Rregullat për Rivendosjen në Afat të Kërkesave të Dorëzuara Jashtë Afateve Ligjore

Bazuar në të dhënat zyrtare që disponohen nga Ministria e Drejtësisë³⁵, rezultojnë 21,900 kërkesa brenda afateve ligjore, nga të cilat:

- Kategoria Dënim kapital/Vrasje pa gjyq, burgim, izolim në hetuesi/institucion mjekësor: **13,300** aplikime të miratuara/përfunduara me 30 Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM); **728** aplikime në proces shqyrtimi; **2,986** aplikime të cilat nuk plotësojnë kriteret ligjore për dëmshpërblim.
- Kategoria internim/dëbim: **4,886** aplikime, për të cilat pritet VKM-ja për trajtimin me skemë pensioni, në referim të *nenit 6, pika c), të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar*. Ky proces nuk ka vijuar ende dhe për pasojë nuk ka një akt nënligjor. Ministria e Financave është institucioni kryesor për hartimin e këtij akti, si institucion epror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), që mbulon politikat e pensioneve.

Kategoria	Statusi i aplikimeve	Numri
Dënim kapital/ Vrasje pa gjyq	Aplikime të miratuara/përfunduara (30 VKM)	13,300
	Aplikime në proces shqyrtimi/verifikimi	728
	Aplikime që nuk plotësojnë kriteret ligjore	2,986
Internim/Dëbim	Aplikime në pritje për VKM dhe trajtim me skemë pensioni	4,886

Aplikime të paraqitura jashtë afateve ligjore rezultojnë 3,036 kërkesa (aplikime nga trashëgimtarët e ish-të dënuarëve), dokumentacioni i të cilave

³⁵ Informacioni është mundësuar nga Ministria e Drejtësisë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, përmes kërkesës së dërguar elektronikisht më 3 dhjetor 2024.

administrohet në sektorin arkiv-protokoll. Dokumentacioni për këto aplikime u pranua deri në vitin 2017, duke patur në konsideratë faktin se ligji mund të ndryshohej sërish dhe këto kërkesa do të rivendoseshin në afat.

Afati i paraqitjes së kërkesave ka ndryshuar tre herë nga momenti i miratimit të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, përkatësisht:

1. Me Ligjin nr. 10111/2009, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831/2007, u ndryshua afati i paraqitjes së kërkesave, nga një vit nga hyrja në fuqi e ligjit deri në datën 01.07.2009.
2. Me VKM nr. 933, datë 10.11.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masës së dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht, pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991”, i ndryshuar, vetëm për kategorinë vrasje pa gjyq u rivendosën në afat kërkesat sa i përket kësaj kategorie deri në gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Me Ligjin nr. 27/2017, datë 23.03.2017, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831/2007, u rivendosën në afat kërkesat vetëm sa i përket kategorisë parësore deri në datë 31.12.2017 (ish-të dënuar vetë gjallë).

Nr.	Akti Ligjor	Ndryshimet Kryesore	Afati i Kërkesave
1.	Ligji nr. 10111/2009, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831/2007	Ndryshoi afatin e paraqitjes së kërkesave	Deri më 01.07.2009
2.	VKM nr. 933, datë 10.11.2010, i ndryshuar	Rivendosi në afat kërkesat për kategorinë e vrasjeve pa gjyq	Deri në 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi
3.	Ligji nr. 27/2017, datë 23.03.2017, Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831/2007	Rivendosi në afat kërkesat vetëm për kategorinë parësore (ish-të dënuar vetë gjallë)	Deri më 31.12.2017

Ndryshimet në masën e dëmshpërblimit financiar miratohen me VKM, në përputhje me parashikimet e paragrafit të fundit të nenit 29, të Ligjit nr. 9831/2007, i ndryshuar, ku përcaktohet që *“gabimet e bëra në të dhëna ose në llogaritjen e masës së shpërblimit, ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e dëmshpërblimit financiar, mund të rishikohen me vendim të Këshillit të Ministrave”*. Në lidhje me parashikimet ligjore, Ministria e Drejtësisë ka proceduar në vijimësi sipas rasteve të paraqitura, duke kërkuar ndryshimet sipas VKM-ve përkatëse. Procesi i dëmshpërblimit është i ndarë në këste dhe prioritet u jepet kategorive të caktuara, si ish-të dënuarit politikë që janë ende gjallë, veçanërisht ata mbi 75 vjeç, gratë dhe ata me sëmundje të rënda.

Lidhur me administrimin e dokumentacionit provues, që vërteton vuajtjen e dënimit për motive politike, në zbatim të nenit 11 të Ligjit 9831/2007, i ndryshuar, Ministria e Drejtësisë, bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor.

Sa i përket dokumentacionit të administruar nga institucionet e lartpërmendura, me krijimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2015, *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”* dhe VKM-së nr. 98, datë 15.02.2017 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit në administrimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të materialeve arkivore të Ish-Sigurimit të shtetit, që gjenden në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Shërbimin Informativ të Shtetit dhe në Autoritetet e tjera publike”*, këto akte, të periudhës 29 nëntor 1944 deri më 2 korrik 1991, i kanë kaluar për administrim këtij institucioni.

Referuar Kreut IV të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, *“Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politik të regjimit komunist”*, i ndryshuar, vendimmarrja për shpërndarjen dhe buxhetimin e pagesave të dëmshpërblimeve për këtë kategori realizohet me Vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, ndërsa Ministria e Drejtësisë, në bashkërendim me institucionet përkatëse, nxjerr numrin e përfituesve dhe shumën e dëmshpërblimit financiar, të cilat më pas ia dërgon për miratim Këshillit të Ministrave. Në përputhje me këtë ligj dhe aktet rregullatore në fuqi, përfshirë Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30,

datë 07.12.2023 dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë nr. 273/1, datë 27.08.2012, Ministria e Financave kryen pagesat e dëmshpërblimeve në mënyrë proporcionale për secilin përfitues, deri në likuidimin e plotë të shumës së përcaktuar. Këto dispozita dhe procedura rregullatore përbëjnë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet analiza e të dhënave të dërguara nga Ministria e Financave, si përgjigje ndaj kërkesës së bërë për këtë studim.³⁶

1. Numri i përgjithshëm i dosjeve të miratuara deri më tani: Miratuar 13,518 dosje për dëmshpërblim.
2. Detyrimi financiar: Shuma totale e detyrimit të qeverisë për këto pagesa është 52,632,790,205 lekë (rreth 520 milion Euro).
3. Kategorizimi i përfituesve:
 - Ish-të dënuarit me burgim (parësorë, që jetojnë në momentin e pagesës): 11,144 dosje;
 - Ish-të dënuarit me dënim kapital (vdekje): 2,114 dosje;
 - 82.4% e dosjeve të miratuara i përkasin ish-të dënuarve me burgim, **ndërsa** 15.6% përfshijnë dënime kapitale;
 - **260 dosjet me vlerë zero** rezultojnë se kanë patur pagesa të mëparshme, por gjithsesi këto raste janë përfshirë në vendimmarrje për të siguruar një dokumentim të plotë të procesit.

³⁶ Informacion i vënë në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, përmes kërkesës së dërguar elektronikisht më 4.12.2024.

IV. Shpërndarja dhe Përdorimi i Fondit Vjetor të Buxhetit të Shtetit për Dëmshpërblimin e Ish-të Përndjekurve Politikë (2005-2025)

Gjatë periudhës 2005-2009, fondet për këtë kategori u rritën në mënyrë progresive, duke kulmuar në vitin 2009. Ndërsa në vitet në vijim (2010-2011),³⁷ buxheti për ish-të përndjekurit politikë mbeti në një nivel më të ulët dhe të qëndrueshëm, ndërsa në vitin 2012³⁸ u vu re një rënie e konsiderueshme e fondeve. Në këtë mënyrë, pjesa e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), e dedikuar për këtë zë ka ndjekur një trend të rritjes deri në 2009, e më pas është ulur. Megjithatë, realizimi faktik i shpenzimeve ka qenë përgjithësisht më i ulët se parashikimet fillestare. Në disa raste, shumat e lëvruara nuk kanë arritur të përmbushin objektivat buxhetore. Për shembull, në vitin 2007³⁹ vetëm 50% e shumës së parashikuar u realizua deri në muajin nëntor, ndërsa në vitin 2009 realizimi ishte rreth 69%. Në vitet e mëvonshme, realizimet faktike kanë vijuar

37 http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/buxheti_2010_tabelat_e_miratuara_ne_kuvend_141209_306_1.xls;

38 http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/buxheti_2012_tabelat_kuvendi1_2890_1.xls

39 http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/treguesit_fiskale_sipas_buxhetit_te_konsoliduar_nentor_2007_1225_1.pdf

të jenë të ulëta, si në vitin 2010 kur vetëm gjysma e fondit të parashikuar u shpërnda.

Sipas një studimi të Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), të publikuar në vitin 2019, nga fillimi i këtij procesi deri në atë kohë ishin shpërndarë rreth 19 miliardë lekë (afërsisht 180 milionë euro) në formë dëmshpërblimesh, ndërsa mbeteshin ende për t'u shpërndarë rreth 32.3 miliardë lekë të tjera (rreth 300 milionë euro). Nëse fondet do të shpërndaheshin me të njëjtin ritëm si në vitet e fundit para publikimit të studimit (2019), parashikohej që procesi i dëmshpërblimeve të zgjaste edhe më shumë se një dekadë tjetër.⁴⁰

Sipas Ligjit nr. 70/2019 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018”, kompensimi për ish-të përndjekurit politikë, për vitin 2018, u realizua në masën 49.9% të planit vjetor fillestar. Kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2017 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një ulje në masën 56.6% ose rreth 1.3 miliardë lekë më pak në terma nominalë. Kjo reflekton ndryshimet e reja në bazën ligjore respektive, të cilat u miratuan vetëm gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018 dhe, për rrjedhojë ngadalësuan ekzekutimin e fondit për vitin 2018.⁴¹

Sipas raportit të buxhetit të vitit 2022, *shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë për vitin 2022 u realizuan në masën 996 milionë lekë, duke rezultuar në 99.6% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe të ndryshuar, sipas Aktit Normativ (AN) nr.19 dhe planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me realizimin e vitit 2021, shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 9.1% ose 83 milionë lekë më shumë.*⁴²

Sipas raportit të buxhetit të vitit 2023, *shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë, për vitin 2023 u realizuan në masën rreth 1.1 miliardë lekë, duke rezultuar në 109.8% e planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 99.8% e planit vjetor të ndryshuar me AN nr.6 dhe e planit vjetor me ndryshime, shpërndarje rezervash. Krahasuar me vitin 2022 shpenzimet për këtë zë*

40 Vukaj, Erblin. “(Mos)rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë në procesin e drejtësisë tranzitore (1991–2018)”. Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), 2019. <https://www.idmc.al/media/files/IDMC-mos-rehabilitimi-ish-perndjekurve-politike.pdf>

41 Ligj nr. 70/2019 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2018”, fq.68, https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Ligji-Nr.70_2019-Per-miratimin-e-buxhetit-Faktik-te-vitit-2018.pdf;

42 [Raporti-per-zbatimin-e-buxhetit-vjetor-situaten-makroekonomike-dhe-fiskale-gjate-vitit-2022-FINAL.docx](#)

rezultojnë me një rritje prej 10.2% ose 101 milionë lekë më shumë.⁴³

Sipas buxhetit të vitit 2025, kompensimi për ish-të përndjekurit është parashikuar të rritet me 17% në vitin 2025, duke arritur në 1.4 miliardë lekë (0.05% e PBB-së, rreth 13 milionë Euro),⁴⁴ nga 1.2 miliardë lekë në vitin 2024 (rreth 11 milionë Euro)⁴⁵. Për vitin 2026, buxheti parashikohej të ishte 1.6 miliardë lekë (rreth 15 milionë Euro), ndërsa në vitin 2027 parashikohet të arrijë në 2 miliardë lekë (rreth 19 milionë Euro).

Nga të dhënat më të fundit të publikuara, rezultojnë që trajtimi financiar i ish-të përndjekurve politikë për vitin 2026, në bazë të Relacionit mbi Projektligjin “Për buxhetin e vitit 2026”, të depozituar në Kuvend, dhe që pasqyron të dhënat zyrtare mbi trajtimin financiar të ish-të përndjekurve politikë:⁴⁶

- Për vitin 2026 është parashikuar një fond prej 1.5 miliardë lekësh, i cili përfaqëson rreth 0.1% të PBB-së. Gjithsesi, ky fond rezultojnë në vlerë më të vogël nga ai që ishte parashikuar/premtuar apo deklaruar. Ky fond synon vijimin e procesit të dëmshpërblimit financiar për ish-të përndjekurit politikë dhe trashëgimtarët e tyre, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.
- Të dhënat e ekzekutimit buxhetor për periudhën 9-mujore të vitit 2025 tregojnë se shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politikë janë realizuar në vlerën 595 milionë lekë, duke përfaqësuar 65.5% të planit të periudhës dhe 42.5% të planit vjetor të rishikuar.

Sipas publikimeve, Ministria e Financave ka filluar lëvrimin e kështit të pestë, në bazë të Urdhrit të Ministrisë së Financave Nr. 12, datë 20.08.2025. Kjo procedurë bëhet në zbatim të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 14.01.2011, “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish-të dënuar politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.⁴⁷

43 Raporti për përdorimin e Fondit Rezervë dhe Kontigjencave për vitin 2023

44 [202410281010351699RELACION - BUXHETI 2025.pdf](#);

45 [Ligji i Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024](#)

46 Relacion mbi Projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2026”, faqe 18 &

83, Kuvendi i Shqipërisë; <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202511041330558470RELACION%20-%20BUXHETI%202026.pdf>;

47 <https://financa.gov.al/newsroom/ministria-e-financave-nis-procedurat-e-pageses-se-kestit-te-pestes-per-trashegimtarat-e-ish-te-denuarve-politike/>;

Një problematikë e identifikuar edhe nga të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë rezultojnë se, për vitin 2025, rreth 3,036 dosje janë dorëzuar jashtë afatit ligjor, duke i përjashtuar këto subjekte nga përfitimi i kompensimit financiar.⁴⁸

Tabela e Planifikimit të Fondit

Viti	Fondi (miliardë lekë)	Rritja (%)
2024	1.2	-
2025	1.4	16.67
2026	1.6	14.29
2027	2.0	25.0

IV. 1. Analizë Analitike e Shpërndarjes së Dëmshpërblimit për ish-të Përndjekurit Politikë⁴⁹

Në këtë seksion do të analizojmë kategoritë dhe numrin e kësteve të çelura, pagesat e kryera dhe detyrimin financiar të mbetur, si dhe statusin e dosjeve të miratuara për dëmshpërblim.

- Kategoritë dhe numri i kësteve të çelura:
 - Kategoria parësore (ish-të dënuarit politikë që jetojnë): **janë hapur 22 këste**, duke përfshirë **2,487 individë**;
 - Kategoria joparësore (familjarët e viktimave të ekzekutuara, të internuarit, të dëbuarit dhe trashëgimtarët e të dënuarve të ndjerë): **janë hapur 4 këste**.
- Pagesat e kryera dhe detyrimi financiar i mbetur: Nga **viti 2008** deri tani, janë paguar **24.64 miliardë lekë** (rreth 230 milionë Euro), që përfaqësojnë **47% të totalit** të miratuar me VKM. **Detyrimi i mbetur** për pagesë është **27.85 miliardë lekë** (rreth 260 milionë Euro), ose **53% e totalit**.

⁴⁸ Informacion i vënë në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, përmes kërkesës së dërguar elektronikisht, datë 4.12.2024.

⁴⁹ Informacion i vënë në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, përmes kërkesës së dërguar elektronikisht, datë 4.12.2024.

- Statusi i dosjeve të miratuara për dëmshpërblim:
 - **Totali i dosjeve të miratuara: 13,518**
 - **Të dëmshpërblyera: 1,985 (parësore) + 323 (joparësore) = 2,308 dosje**
 - **Humbur të drejtën: 545 dosje** (për shkak të mosparaqitjes së dokumenteve në kohën e përcaktuar ligjërisht).
 - **Në proces gjyqësor: 25 dosje**
 - **Mbyllur përfundimisht: 3,138 dosje**
 - **Në proces për pagesë: 10,380 dosje**

IV.2. Administrimi dhe Përdorimi i Fondit të Buxhetit për Institutin e Integritit të Ish-të Përndjekurve Politikë⁵⁰

Instituti i Integritit të Ish-të Përndjekurve Politikë (IIP) funksionon duke u mbështetur në një fond buxhetor të veçantë, i cili është pjesë e programit të rehabilitimit të ish-të përndjekurve politikë. Ky fond është miratuar fillimisht si pjesë e buxhetit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për vitin 2018, dhe më pas është përfshirë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në programin “Rehabilitimi i ish-të Përndjekurve Politikë”.

Fondi është krijuar në bazë të Ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992⁵¹, dhe përbëhet nga:

- Shpërndarjet vjetore nga buxheti i shtetit;
- Një përqind e fondeve të pagave të derdhura nga ndërmarrjet shtetërore jobuxhetore;
- Një pjesë e ndihmave humanitare të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;
- Kontribute nga institucione bamirëse dhe donatorë privatë, vendas ose të huaj.

⁵⁰ Kontrolli i Lartë i Shtetit, Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Institutin e Integritit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit, fq.49; <https://panel.klsh.org.al/storage/php9dj5fg.pdf>;

⁵¹ Ligji nr. 7598, datë 01.09.1992, Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të përndjekurit politikë, si dhe VKM nr. 392, dt. 12.08.1999, “Për administrimin e fondit të veçantë monetar të krijuar sipas Ligjit nr. 7598, dt. 01.09.1992”

Administrimi i fondit bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 12.08.1999, dhe ndjek këto kritere: **50% e fondit** shpenzohet për ndihma ekonomike dhe materiale për familjet e përndjekura, me qëllim integrimin e tyre shoqëror dhe përbalimin e nevojave urgjente; **50% e fondit** përdoret për të financuar shoqatat e ish-të përndjekurve politikë, bazuar në numrin e anëtarëve të tyre.

Këto masa synojnë mbështetjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së ish-të përndjekurve politikë dhe familjeve të tyre, duke garantuar një proces transparent dhe efektiv të shpërndarjes së fondeve.

Tabela e Shpërndarjes së Fondit (në mijë lekë)⁵²

Viti	Ndihma Ekonomike	Sponsorizim	Shoqatat	Totali
2018	6,040	1,532	15,060	22,632
2019	7,480	508	36,540	44,528
2020	4,800	155	34,130	39,085
2021	4,345	40	37,330	41,715
2022	1,695	584	1,520	3,799

Fondet e shpërndara për ndihmën ekonomike, sponsorizimet dhe shoqatat pasqyrojnë ndryshime të theksuara në vite, duke treguar një tendencë uljeje të përgjithshme, sidomos pas vitit 2019. Fondet e ndihmës ekonomike arritën kulmin e tyre në vitin 2019, me një total prej 7.48 milionë lekësh, duke shënuar një moment të rëndësishëm mbështetjeje për këtë kategori. Megjithatë, pas këtij viti, fondet kanë ndjekur një trajektore rënëse. Deri në vitin 2022, shumta e akorduar u ul në një minimum prej vetëm 1.695 milionë lekësh, duke reflektuar një tkurrje të madhe në mbështetje ekonomike. Në vitin 2021, sponsorizimet shënuan një ulje drastike, duke arritur vetëm 40 mijë lekë. Kjo situatë pati një përmirësim të lehtë në vitin 2022, me një rritje modeste në 584 mijë lekë, ndonëse kjo shifër mbetet ende e ulët në raport me kategoritë e tjera. Mbështetja financiare për shoqatat arriti kulmin në vitin 2021, me një total prej 37.33 milionë lekësh, që tregon një angazhim të theksuar për nxitjen

52 Kontrolli i Lartë i Shtetit Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në institutin e integritetit të ish të përndjekurve politik dhe institutin e studimeve për krimet dhe pasojat e komunizmit, fq152, <https://panel.klsh.org.al/storage/php9dj5fg.pdf>

e aktiviteteve shoqërore dhe organizative gjatë këtij viti. Megjithatë, në vitin 2022 pati një rënie drastike në këtë kategori, me fondet që ranë në vetëm 1.52 milionë lekë, një diferencë e madhe krahasuar me vitet e mëparshme. Shpërndarja totale e fondeve ka pasur gjithashtu një ulje të ndjeshme gjatë viteve. Në vitin 2019, totali arriti vlerën më të lartë prej 44.528 milionë lekësh, duke shënuar një vit rekord për mbështetjen financiare në të gjitha kategoritë. Megjithatë, në vitin 2022 fondet totale u tkurrën ndjeshëm, duke arritur në vetëm 3.799 milion lekë. Kjo rënie e madhe tregon sfidat ekonomike dhe ndryshimet në prioritetet e shpërndarjes së fondeve.

V. Pajtueshmëria me Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

Procesi i kompensimit për ish-të përndjekurit politikë në Shqipëri duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat kërkojnë dëmshpërblim të plotë, të drejtë dhe efektiv për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KPDCCP), Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ofrojnë një kornizë të gjerë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe kërkojnë që shtetet të sigurojnë:

- Dëmshpërblim për çdo shkelje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë arrestimet arbitrare dhe burgosjet e padrejta;
- Të drejtën për riparim efektiv për viktimat e shkeljeve të rënda;
- Kompensim të drejtë dhe proporcional, i cili duhet të përfshijë pagesa financiare, kthimin e pronave dhe përfitime të tjera sociale dhe morale.

Në vitin 2004, Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara⁵³, duke analizuar detyrimet ligjore të shteteve të parashikuara nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, bëri një përkufizim të qartë të të drejtës për riparim, duke sanksionuar, ndër të tjera, se *“detyrimi për të ofruar mjete juridike efektive për individët, të cilëve u janë shkelur të drejtat e përcaktuara nga Pakti, nuk përmbushet nëse këtyre individëve nuk u ofrohet*

53 Komiteti i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara, Komenti i Përgjithshëm Nr. 31: Natyra e Detyrimit të Përgjithshëm Juridik të Vendosur ndaj Shteteve Palë në Pakt (2004)

kompensim". Rezoluta 60/147/2006 e Asamblesë së Përgjithshme përcaktoi se çfarë përfshin e drejta për riparim, duke përfshirë specifikisht:

- Restitucion, masa të synuara për të kthyer viktimat në situatën fillestare përpara shkeljeve të rënda të të drejtave ndërkombëtare të njeriut, si për shembull, rikthimi i lirisë, gëzimi i të drejtave të njeriut, rikthimi në punë, kthimi i pronës;
- Kompensim, masa ekonomike për dëmet fizike apo mendore, humbjet e mundësive, dëmet materiale dhe morale të shkaktuara nga shkeljet masive të të drejtave të njeriut;
- Rehabilitim, si masa të kujdesit mjekësor dhe psikologjik, ofrimi i shërbimeve ligjore dhe sociale;
- Dëmshpërblim moral për të dëmtuarit, si masa që zhvendosin vëmendjen nga viktimat te autorët e shkeljeve, përmes përpjekjeve për t'i ndjekur penalisht dhe për të vendosur të vërtetën në nivele politike, ligjore, shkencore dhe kulturore;
- Garanci për mospërsëritje, përfshirë reforma institucionale dhe masa që synojnë konsolidimin e demokracisë dhe mekanizmave të shtetit të së drejtës, të cilat mund të minimizojnë gjasat që të përsëriten shkelje të tjera masive të të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst, Shqipëria ka detyrimin t'i zbatojë këto standarde duke siguruar një proces transparent dhe të drejtë kompensimi për ish-të përndjekurit politikë, në përputhje me konventat që ka ratifikuar.

Në raportin e vitit 2023 mbi progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE)⁵⁴, theksohet se zbatimi i skemave të dëmshpërblimit për ish-të përndjekurit politikë dhe ish-pronarët mbetet një sfidë madhore për vendin. BE ka rekomanduar përmirësime në transparencën dhe efikasitetin e këtij procesi për të përmbushur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Sipas një analize nga DWP Balkan, Shqipëria ka bërë përparime në disa aspekte të drejtësisë tranzitore, por ende përballlet me sfida në arritjen e standardeve ndërkombëtare. Në veçanti, theksohet nevoja për programe më të forta rehabilitimi që adresojnë nevojat psikologjike dhe sociale të viktimave, përveç kompensimeve financiare.⁵⁵

54 [ea0a4b05-683f-4b9c-b7ff-4615a5fffd0b_en](#)

55 [Profili i shumëfyturëshit i drejtësisë tranzitore në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e Veriut - DWP-BALKAN](#)

VI. Problematikat dhe Sfidat në Zbatimin e Akteve Ligjore

Gjatë vitit 2009 e në vijim, *Avokati i Popullit* ka kushtuar një rëndësi të veçantë çështjes së pagesave të kësteve të dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë dhe trashëgimtarët e tyre. Ai ka trajtuar, gjithashtu, domosdoshmërinë e ndryshimeve ligjore dhe miratimin e akteve nënligjore për të drejtat e tjera që duhet të përfitojë kjo kategori (Raportet e Avokatit të Popullit, 2020-2023) duke vënë në dukje:

- Mungesën e realizimit të detyrimeve ligjore: Nuk ka një afat të saktë për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit, duke e vonuar rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.⁵⁶
- Pamjaftueshmërinë e buxhetit: Avokati i Popullit vëren se përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë është e pamjaftueshme për ta përfunduar këtë proces brenda një kohe optimale. Viti 2022 kishte parashikuar vetëm një

56 <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20verpimtaris%C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf>; fq.72, "Përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohe optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme."

miliard lekë për këtë kategori, një shifër që ka ardhur duke u ulur vitet e fundit. Kjo ulje e ndjeshme e fondeve thekson nevojën urgjente për rishikimin e këtij buxheti për vitet në vijim.⁵⁷

- Realizimin efektiv të të drejtave: Përveç njohjes së të drejtave për këtë kategori, ato duhet të realizohen efektivisht nga shteti, brenda afateve të arsyeshme.
- Një shqetësim tjetër është mosmarrja e dëmshpërblimit për individët që i përkasin kategorive të *internimit* dhe *dëbimit*, ndonëse ligji e njeh të drejtën e tyre për trajtim.
- Një faktor tjetër pengues është afati prekluziv i vendosur për aplikimet për dëmshpërblim, që ka krijuar diskriminim dhe ka kufizuar aksesin për shumë individë që e meritojnë këtë përfitim.

Raporti i Avokatit të Popullit për vitin 2023 nënvizon rëndësinë që i është kushtuar ish-të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre. Në të njëjtin raport, theksohet se përqindja e planifikuar në buxhetin e shtetit për dëmshpërblimin e kësaj kategorie mbetet në nivel të pamjaftueshëm. Si rezultat, procesi i kompensimit pritet të vijojë të zvarritet për vite me radhë, duke e bërë të pamundur përfundimin e tij brenda një periudhe kohore optimale.⁵⁸ Ky institucion ka adresuar një rekomandim të veçantë për *Këshillin e Ministrave*, duke përfshirë shqetësime lidhur me pagesën efektive të dëmshpërblimit, rrethet e *trashëgimtarëve*, premisat ligjore dhe detyrimin për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kjo është thelbësore për të garantuar që të gjitha grupet e prekura të kenë mundësi të barabarta për të përfituar nga ligji.

VI.1. Kriteret për të Vlerësuar Efektivitetin e Procesit

Më poshtë do të paraqesim disa kritere për vlerësimin e efektivitetit të procesit.

⁵⁷ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%202019%20-%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

⁵⁸ [FINAL-RAPORTI VJETOR 2023.pdf](#); <https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>;

- *Koha e Zbatimit dhe Transparenca:* Një nga kriteret kryesore për të vlerësuar efektivitetin e procesit të kompensimit është koha e zbatimit. Në Shqipëri, procesi ka qenë i zgjatur, me shumë raste të vonesave prej dekadash, që kanë ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien e ish-të përndjekurve. Transparenca është një tjetër faktor i rëndësishëm. Megjithëse ka pasur përpjekje për të zbatuar një sistem të qartë të kompensimit, ka raportime nga Avokati i Popullit për mungesë të informacionit dhe probleme mbi mënyrën e shpërndarjes së fondeve në disa raste.
- *Drejtësia dhe Efiçenca:* Përsa i përket drejtësisë, procesi ka përfshirë disa kategori të përfituesve në mënyrë të diferencuar. Ish-të përndjekurit, që kanë kaluar më shumë vite në burg ose kampe të punës, janë përfshirë në skema të ndryshme, por disa individë, veçanërisht ata me përndjekje më të shkurtër, kanë përfituar më pak. Efiçenca ka qenë një problem madhor për shkak të burokracisë dhe mungesës së fondeve të qëndrueshme, të cilat kanë bërë që procesi të mos funksionojë gjithmonë siç pritej.

Një raport i Bankës Botërore (2012) mbi proceset e kompensimit në vendet post-komuniste thekson se mekanizmat e Shqipërisë për kompensim janë më të vonuar dhe më të ndërlikuar, krahasuar me vende si Polonia apo Republika Çeke. Zbatimi i dobët ka ndikuar në besimin e qytetarëve ndaj sistemit dhe ka krijuar një ndjenjë të theksuar padrejtësie.

- *Ndikimi në Jetën Ekonomike të Viktimave:* Vonesa në procesin e kompensimit ka pasoja në jetën e ish-të përndjekurve politikë. Shumë prej tyre janë plakuar pa marrë kompensimet e premtuara, duke përjetuar vështirësi ekonomike të mëdha. Për shkak të moshës dhe problemeve shëndetësore të shkaktuara nga përndjekja, shumë prej tyre nuk kanë qenë në gjendje të punojnë për të patur një jetesë të denjë. Raportet nga organizatat e të drejtave të njeriut tregojnë se një numër i madh ish-të përndjekurish kanë ndërruar jetë pa marrë asnjë kompensim, duke e lënë situatën e tyre të pazgjidhur dhe duke krijuar probleme për trashëgimtarët e tyre.

Në tetor të vitit 2024, gjashtë ish-të burgosur politikë nisën një grevë urie pranë Parlamentit të Shqipërisë, duke kërkuar pensione speciale dhe pagesa për punën e kryer gjatë kohës së burgimit, të cilat pretendojnë se nuk u janë

paguar.⁵⁹ Gjatë ditës së katërt të grevës, një prej grevistëve, 84-vjeçar, u dërgua me urgjencë në spital për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore, e cila u përkeqësua nga problemet me zemrën dhe mungesa e ushqimit.⁶⁰

Puna e ISKK-së⁶¹ dhe organizatave të tjera synon të dokumentojë dhe të kujtojë krimet e komunizmit, për të siguruar që ato të mos harrohen dhe të mos përsëriten. Në përpjekje për të trajtuar këto çështje, janë krijuar edhe platforma online që ofrojnë informacione dhe shërbime për ish-të përndjekurit, duke synuar lehtësimin e qasjes të tyre në të drejtat dhe përfitimet e parashikuara me ligj.⁶²

59 [Balkanweb](#), 14 Tetor 2024, "Prej 4 ditësh, 6 ish të burgosur politikë po zhvillojnë një grevë urie jashtë godinës së ish-të përndjekurve politikë, vetëm pak metra larg Parlamentit."

60 [A2 News](#), 17 Tetor 2024

61 Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK) është një institucion i ngritur për të dokumentuar, hulumtuar dhe shpallur publikisht të dhënat mbi krimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë regjimit komunist në Shqipëri (1944-1991). Ai shërben si një mekanizëm për të ndriçuar periudhën totalitare dhe për të ofruar drejtësi simbolike për viktimat e regjimit.

62 [TLAS Portal](#)

VII. Perspektivat dhe Përmirësimet e Mundshme Ligjore

Procesi i kompensimit për ish-të përndjekurit politikë në Shqipëri ka hasur në shumë sfida dhe vonesa, të cilat kanë nxjerrë në pah nevojën për rishikimin e kuadrit ligjor. Ligjet aktuale për dëmshpërblim, të miratuara që pas rënies së regjimit komunist, kanë pësuar disa ndryshime, por ato nuk kanë qenë të mjaftueshme për t'i trajtuar të gjitha problematikat.

Një nga përmirësimet e domosdoshme është krijimi i një mekanizmi të qëndrueshëm financiar, që do sigurojë vazhdimësinë e pagesave për ish-të përndjekurit pa ndërprerje. Kjo do të kërkonte rishikim të buxhetit të dedikuar dhe krijimin e një fondi të posaçëm për kompensim, i cili të jetë i pavarur nga ndryshimet politike dhe krizat financiare.

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) ka propozuar disa ndryshime në ligjin për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist. Ndryshimet përfshijnë rritjen e masës së dëmshpërblimit për individë dhe familjarë që kanë vuajtur si pasojë e persekutimit politik, duke e konsideruar si një nevojë urgjente trajtimin e situatës së ish-të internuarve në kampe me tela me gjemba. Propozimi përfshin një trajtim të veçantë për individët që kanë lindur në internim ose që ishin të mitur gjatë periudhës së internimit.⁶³ Kjo masë synon të eliminojë diskriminimin

63

<https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>

dhe të sigurojë që, të gjithë ata që kanë vuajtur në këto kushte të kenë mundësi për të përfituar dëmshpërblim, qoftë edhe simbolik. Një rekomandim tjetër është prioritizimi i pagesave për rrethin e familjarëve të viktimave të vrara gjatë regjimit komunist. Kjo nënkupton harmonizimin e përkufizimeve në ligj dhe barazimin e masës së dëmshpërblimit me bazë në vitet e burgimit, duke e rritur atë nga tetë në 25 vite burgim.⁶⁴ Sipas nenit 7 të Ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, të ndryshuar, familjarët e viktimave të pushkatuara apo ekzekutuara padrejtësisht me dënime politike, për vuajtjet dhe persekutimin e pësuar, përfitojnë një dëmshpërblim financiar të barazvlefshëm me kompensimin për tetë vite burgim. Kjo e drejtë për të kërkuar dëmshpërblim është një e drejtë jopasurore dhe vetjake. Për të gjitha këto grupe përfituese, sugjerohet zgjatja e afatit për aplikimet deri më 31 dhjetor 2026, për të krijuar mundësi të mjaftueshme për verifikim dhe përfitim.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është shpejtimi i procesit të dëmshpërblimit. Kjo përfshin rekomandimin për të shpejtuar procesin për dëmshpërblimet e mbetura, sidomos për ata që kanë probleme shëndetësore. Për këta individë sugjerohet mundësia e pagesës së shumës së mbetur në një këst total të vetëm. Për më tepër, një propozim i rëndësishëm përfshin që individët që kanë kryer punë të detyruar gjatë internimit të kenë të drejtë për një pagesë fikse mujore si shpërblim për punën e tyre, e cila nuk do të preket nga përfitimet e tjera të deritanishme.

Nisma ligjore janë depozituar nga deputë (2 nëntor 2022 dhe 6 qershor 2023), për disa ndryshime në Ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar. Sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit, i miratuar në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve më 9 tetor 2024, projektligji ishte planifikuar për diskutim në periudhën 14 tetor - 1 nëntor 2024. Gjithsesi, pavarësisht përfshirjes në këtë kalendar dhe faktit se ishte planifikuar për shqyrtim edhe në periudhën shkurt 2025, deri më tani ai ende nuk është trajtuar nga komisioni përkatës.⁶⁵

64 Prioritizimin, për efekt pagese, të rrethit të familjarëve për viktimat e vrara apo të ekzekutuara gjatë komunizmit; harmonizimin e përkufizimit, në nenin 8, të "rrethit të familjarëve" dhe rrethit të trashëgimtarëve me Kodin Civil, për qëllime të përfitimit sipas nenit 7 të ligjit; si dhe barazimin e masës së dëmshpërblimit sipas nenit 7 jo me 8 vite burgim, por me 25 vite burgim. <https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>

65 [Kuvendi i Shqipërisë 202501301613581975Kalendar i punimeve të Kuvendit për periudhën 10 shkurt - 28 shkurt 2025.pdf](#);

VIII. Përfundime

Dëmshpërblimi i plotë dhe i drejtë për ish-të përndjekurit politikë nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një detyrim moral dhe një hap i domosdoshëm për të siguruar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët e saj. Rehabilitimi dhe kompensimi i ish-të dënuarve politikë në Shqipëri ka qenë në qendër të vëmendjes së shtetit që pas përmbysjes së regjimit komunist, por përpjekjet fillestare për trajtimin e kësaj çështjeje kanë qenë të fragmentuara dhe jo të plota. Pavarësisht miratimit të disa ligjeve dhe vendimeve të qeverisë gjatë viteve 1991-1993 (Ligji nr. 7514/1991 dhe Ligji nr. 7598/1992), efektet konkrete ishin të kufizuara dhe shpesh herë vetëm deklarative.

Me miratimin e Ligjit nr. 9831 më 12.11.2007, „Për kompensimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist“, i ndryshuar, filloi një proces më i strukturuar dhe i qëndrueshëm për kompensimin financiar dhe moral të kësaj kategorie. Megjithatë, zbatimi konkret i ligjit u vonua deri në vitin 2008, dhe efektet e tij të pjesshme filluan të ndjehen vetëm në vitin 2009 e më tej. Kjo vonesë ka lënë një numër të madh ish-të përndjekurish politikë ende në pritje të drejtësisë së plotë, dhe megjithëse janë marrë disa hapa pozitivë, mbetet ende një sfidë e rëndësishme për shoqërinë shqiptare që të përmbushë plotësisht angazhimet ndaj kësaj kategorie.

Kompensimet për grupet e prekura mbeten një temë me rëndësi kritike dhe komplekse. Edhe pse fondi i planifikuar buxhetor paraqet një rritje të lehtë,

periudha e saktë për përfundimin e shlyerjes së plotë mbetet ende e paqartë. Kjo pasiguri lidhet me disa faktorë kryesorë, si numri total i përfituesve, dinamika e kërkesave të reja, masa e fondeve të dedikuara për çdo vit buxhetor, dhe efikasiteti i proceseve administrative për shpërndarjen e këtyre fondeve. Për më tepër, zbatimi efektiv i programit kërkon transparencë dhe monitorim të vazhdueshëm, për të siguruar që shpërndarja e fondeve të jetë e drejtë dhe në përputhje me nevojat prioritare. Një strategji më e qartë dhe e koordinuar për rritjen graduale të buxhetit mund të ndihmojë në përshejtimin e procesit dhe në zvogëlimin e barrës për përfituesit që presin prej vitesh për marrjen e përfitimeve.

Në këtë kuadër, është thelbësore që institucionet përkatëse të përcaktojnë qartë objektivat dhe të publikojnë afate të përafërta, duke ofruar siguri më të madhe për qytetarët. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile dhe një konsultim i gjerë publik do të kontribuonte, gjithashtu, në rritjen e besimit dhe në përmirësimin e planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit.

Një nga çështjet kryesore për t'u trajtuar është krijimi i një mekanizmi financiar të qëndrueshëm, i cili do të sigurojë që pagesat për ish-të përndjekurit të jenë të vazhdueshme dhe të pavarura nga krizat politike apo financiare. Për këtë arsye, është e nevojshme të rishikohet buxheti i dedikuar dhe të krijohet një fond i posaçëm, që do të veprojë i pavarur nga ndryshimet që mund të ndodhin në qeveri apo ekonomi.

Gjithashtu, një rishikim i thellë i ligjeve që rregullojnë kriteret e përfitimit dhe përlllogaritjen e dëmshpërblimeve do të ndihmonte në garantimin e një procesi të drejtë, gjithëpërfshirës dhe më transparent, duke marrë parasysh vështirësitë dhe pabarazitë me të cilat përballen ish-të përndjekurit dhe familjet e tyre. Vetëm në këtë mënyrë, do të mund të realizohet qëllimi kryesor i kompensimit: t'i rikthejë drejtësinë dhe dinjitetin e humbur kësaj kategorie të shtresës së përndjekur nga regjimi komunist.

Në përfundim, procesi i dëmshpërblimit ka përparuar, por me një ritëm të ngadaltë, pasi deri më tani është paguar vetëm 47% e fondeve (24.639 miliardë lekë), ndërsa 53% (27.848 miliardë lekë) e shumës mbetet ende detyrim. Një pjesë e madhe e dosjeve (nga 13,518 dosje të miratuara për dëmshpërblim, janë përmbyllur pagesat për 3,138 dosje/individ, përfshirë 1,985 dosje

nga kategoria parësore dhe 323 dosje nga kategoria joparësore, 545 dosje kanë humbur të drejtën e përfitimit, dhe 25 dosje janë në proces gjyqësor), konkretisht 10,380 ose 77% e totalit, mbeten në proces për të vijuar pagesat. Për të garantuar përmbushjen e detyrimeve financiare ndaj përfituesve, është i domosdoshëm përsheptimi i këtij procesi.

Procesi i kompensimit për ish-të përndjekurit politikë në Shqipëri është karakterizuar nga vonesa të gjata dhe mangësi burokratike, të cilat kanë ndikuar negativisht në realizimin e tij. Këto probleme kanë shkaktuar zhgënjim te përfituesit dhe kanë penguar përmirësimin e kushteve të tyre jetësore, duke dëmtuar kështu efektivitetin dhe qëllimin e këtij procesi.

IX. Rekomandime

Bazuar në gjetjet e mësipërme, disa rekomandime për përmirësimin e procesit të kompensimit janë si më poshtë:

- Përmirësimi i sistemit të pagesave – Vendosja e një mekanizmi të garantuar dhe të përshpejtuar financiar, me një fond të posaçëm të parashikuar në buxhetin vjetor, për të siguruar pagesa të rregullta dhe në kohë.
- Zgjerimi i formave të kompensimit jo-financiar – Përfitimet e pensionit⁶⁶ dhe lehtësirat sociale duhet të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të zgjerojnë aksesin për të gjithë përfituesit.
- Konsultimi me organizata ndërkombëtare – Përdorimi i praktikave më të mira ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me organizatat për të siguruar që procesi i kompensimit përputhet me standardet për të drejtat e njeriut.

A. Propozimet për Përmirësim

- Përsheptimi i zbatimit të vendimeve ligjore për kompensim përmes krijimit të mekanizmave të shpejtë për shqyrtimin dhe ekzekutimin e kërkesave.

⁶⁶ Krijimi i një skeme të veçantë dëmshpërblimi për vitet e internimit të fëmijëve, të cilëve koha e internimit dhe e dëbimit për motive politike, nuk njihet si vjetërsi pune për të lindurit në internim apo ata që nuk kishin mbushur moshën 15 vjeç. <https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>

- Harmonizimi i legjislacionit me praktikat më të mira ndërkombëtare për kompensimin e viktimave të përndjekjes politike, duke përfshirë standardet e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës.
- Shtimi i kategorive të përfituesve, duke përfshirë familjarët e viktimave që nuk kanë përfituar dëmshpërblim, për shkak të mungesës së dokumentacionit të plotë apo për arsye burokratike.

B. Mundësitë për përshpejtimin e procesit

- Digjitalizimi i procedurave – Mund të reduktohen ndjeshëm vonesat burokratike duke krijuar një platformë online ku ish-të përndjekurit dhe familjarët e tyre mund të dorëzojnë dokumentet e nevojshme dhe të ndjekin statusin e kërkesave të tyre. Ky proces mund të eliminojë nevojën për paraqitjen fizike dhe mund të ulë ndjeshëm kohën e trajtimit të kërkesave.
- Shpërndarje e rregullt e fondeve – Garancia që fondet për dëmshpërblim të jenë të parashikuara dhe të dedikuara çdo vit në buxhetin e shtetit është thelbësore për përshpejtimin e procesit. Një fond i dedikuar dhe i sigurt do të shmangte vonesat për shkak të ndryshimeve politike apo vështirësive financiare.
- Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, të tilla si Këshilli i Evropës ose OSBE, për të marrë ekspertizë teknike dhe financiare që mund të ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve të brendshme.

Referenca

1. Council of Europe. *Measures to Dismantle the Heritage of Former Communist Totalitarian Systems*. Accessed December 2, 2024. <https://www.coe.int>
2. U.S. Department of State. *Justice for Uncompensated Survivors Today (JUST) Act Report to Congress*, released publicly in July 2020, Section 1. Respect for the Integrity of the Person. <https://www.state.gov/reports/just-act-report-to-congress/>
3. Cohen, Andrew I. *Philosophy, Ethics, and Social Justice: Critical Perspectives*. New York: Routledge, 2016.
4. Teitel, Ruti G. *Transitional Justice*. New York: Oxford University Press, 2000.
5. Elster, Jon. *Closing the Books: Transitional Justice in Historical Perspective*. Cambridge: Cambridge University Press, 2004.
6. Roman, D. (2005). *The Transitional Justice Mechanism: Compensation for Former Political Prisoners in Central and Eastern Europe*. *Central European Review*, 6(2), pp. 45-67.
7. Lederach, J. P. (1997). *Building Peace: Sustainable Reconciliation in Divided Societies*. United States Institute of Peace Press.
8. United Nations Human Rights Committee, General Comment No. 31: The Nature of the General Legal Obligation Imposed on States Parties to the Covenant (2004).
9. Vukaj, Erblin. "(Mos)rehabilitimi i ish të përndjekurve politikë në procesin e drejtësisë tranzicionale (1991-2018)". Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC), 2019.

Legjislacioni

1. Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", i ndryshuar.
2. Ligji nr. 7748, datë 29.07.1993, "Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", i ndryshuar.
3. Ligji nr. 9260, datë 15.07.2004, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993, Për Statusin e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë nga Sistemi Komunist".
4. Ligji nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar.
5. Gjykata Kushtetuese, Vendimi nr. 34, datë 20.12.2005.
6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1253, datë 2.7.2008, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të vlerësimit për dëmshpërblimin e përfutur nga ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist".
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 17.11.2010, "Për përcaktimin e procedurave administrative të shqyrtimit të kërkesave dhe kompensimin financiar për familjet e viktimave të dënuara pa të drejtë, pa gjyq, për arsye politike, nga 30.11.1944 deri më 1.10.1991", i ndryshuar.
8. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 419/2011, "Për miratimin e afateve dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të kompensimit për të përndjekurit politikë".
9. Urdhri i Ministrit të Financave nr. 12, datë 20.08.2025, "Për shpërndarjen e kësteve të dëmshpërblimit".
10. Ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Dokumente dhe Raporte

1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, 2023. *Raporti vjetor 2023*. <https://autoritetidosjeve.gov.al/raport-vjetor-2023>
2. Avokati i Popullit, 2023. *Raporti Vjetor 2023*. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/FINAL-RAPORTI%20VJETOR%202023.pdf>
3. Avokati i Popullit, 2021. *Raporti vjetor i veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2021*. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20vepimtaris%C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf>
4. Avokati i Popullit, 2019. *Raporti vjetor 2019*. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%202019%20-%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>;
5. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2023. *Raporti për përdorimin e Fondit Rezervë dhe Kontigjencave për vitin 2023*.
6. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2022. *Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor dhe situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022*.
7. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020. *Final-Raporti i Mes-Vitit mbi Zbatimin e Buxhetit 2020*.
8. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2021. *Raporti i Mes-Vitit 2021* ⁷ *Vlerësimi i situatës Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore për 5-Mujorin 2021 dhe Pritshmëria për 12-Mujorin 2021*.
9. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2004. *Tabelat e Ligjit nr. 9339, datë 21.12.2004*. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/5_tabelat_ligji_nr_9339_date_21_12_2004_458_1.pdf
10. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2008. *Buxheti 2008 – tabelat e Kuvendit*. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/4_buxheti_2008_tabelat_kuvendi_362_1.xls
11. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2010. *Buxheti 2010* ⁷ *tabelat e miratuara në Kuvend*. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/buxheti_2010_tabelat_e_miratuara_ne_kuvend_141209_306_1.xls
12. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2012. *Buxheti 2012 – tabelat e Kuvendit*. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/buxheti_2012_tabelat_kuvendi1_2890_1.xls
13. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2007. *Treguesit fiskale sipas buxhetit të konsoliduar nëntor 2007*. http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/treguesit_fiskale_sipas_buxhetit_te_konsoliduar_nentor_2007_1225_1.pdf
14. *Relacion mbi Projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2026”, Kuvendi i Shqipërisë*; <https://kuvendiwebfiles.blob.core.windows.net/webfiles/202511041330558470RELACION%20-%20BUXHETI%202026.pdf>;
15. Kontrolli i Lartë i Shtetit, 2023. *Raporti vjetor për auditimin e financave publike*. <https://panel.klsh.org.al/storage/php9dj5fg.pdf>
16. Kontrolli i Lartë i Shtetit, 2023. *Raporti mbi menaxhimin financiar publik*. <https://panel.klsh.org.al/storage/phpm7RnTr.pdf>
17. *Kuvendi i Shqipërisë 202501301613581975Kalendari i punimeve të Kuvendit për periudhën 10 shkurt - 28 shkurt 2025.pdf*;
18. *Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit. Studime mbi krimet e komunizmit në Shqipëri, Instituti Për Integrimin të Ish Përndjekurve Politikë - Statistika*

